



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1380\_09\_15**;
- Ankesa e KESCO e datës **06.10.2015**

**në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2016, nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHE**t ankesa e KESCO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Shaban Vllasaliu me shifër DPR - 90026306 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1380\_09\_15** i datës 11.09.2015.

**A r s y e t i m**

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 06.10.2015 ka pranuar ankesën e Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) me të cilën ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. KESCO ne ankesën e saj ka theksuar se konsumatori në pjesën më të madhe për periudhën 10/2011 deri më 05/2015 është faturuar me lexim të rregullt. KESCO ne ankesën e saj i ka paraqit muajit se kur konsumatori është faturuar me rregull dhe pjesët kur nuk është faturuar konsumatori ne rregull por që është faturuar me vlerësim. Ne ankesë është theksuar se nga periudha 10/2011 deri më 05/2015 janë gjithsejtë 44 muaj, ku 35 muaj nga ta janë me lexim, ndërsa 9 muaj janë me vlerësim. KESCO ne ankesë gjithashtu ka theksuar se konsumatori nuk është ankuar asnjëherë edhe ne rastet kur është faturuar me një tarifë dhe i ka paguar faturat e energjisë elektrike. Po ashtu theksohet se konsumatori është ankuar vetëm për faturën 11/2014 në vlerë prej 268.73€ gjë për të cilën edhe është korrigjuar në vlerë prej 102.73€.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se me datë 26.11.2014 konsumatori ka parashtruar ankesë ne Departamentin për Konsumator në KEDS, me të cilën ka kundërshtuar faturimin e KEDS, ku ka kërkuar që t'i rregullohet faturimi në dy tarifa.

Me datë 03.12.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikës matëse kanë dal te konsumatori dhe kanë konstatuar gjendjen e kilovatorëve në njehsorin elektrik, ku sipas të dhënave të përshkruara në procesverbal gjendja e kilovatorëve në tarifën e I është 27396 kWh, ndërsa gjendja e kilovatëve në tarifën e II është 76532 kWh.



Në bazë të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 12.12.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij dhe duke bërë korrigjimin në vlerë financiare prej -102.73€, që përfshin periudhën 09, 10 dhe 11/2014, e kjo bazuar në të dhënat e marra nga procesverbali i inspektimit dhe kontrollës së KEDS procesi nr. 0050558 i datës 03.12.2014.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar ankesën e KESCO-së dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka konstatuar se KESCO në ankesën e saj pjesërisht e ka pohuar se disa muaj nuk ka mund të bëjë faturim të rregullt ashtu siç parashihet me rregullat në fuqi. Lidhur me këtë Bordi ka analizuar edhe periudhën kur KESCO pretendon se duhet të korrigjohet konsumatori dhe për këtë ka konstatuar se kjo periudhë e propozuar nga ankuesi KESCO është në kundërshtim me gjendjen reale që evidentohet në listat e leximit dhe në rrjedhjen e energjisë elektrike se si është faturuar konsumatori për periudhat kontestuese.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje ka konstatuar se organi i shkallë parë DMK, ka vendosur në mënyrë të drejtë duke u bazuar në prova të theksuara edhe në vendim. Bordi gjithashtu ka vlerësuar se DMK ka analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike ku mbi bazën e kësaj ka nxjerr edhe mesataren mujore të shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit. Nga analizat e bëra shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit sipas viteve është vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë për muaj për vite është: 2009 - 662.67 kWh/muaj, 2010 - 786.58 kWh/muaj, 2011 - 920.08 kWh/muaj, 2012 është 790.58 kWh/muaj, 2013 – 818.58 kWh/muaj, 2014 – 1010.92 kWh/muaj, 2015 – 894.25 kWh/muaj.

Bordi gjithashtu ka konstatuar se mbështetur në dispozitat e Rregullës për Kushtet e Përgjithshme në Sektorin e Energjisë përkatësisht nenit 21 theksohet se: **“Operatori i Sistemit mbetet përgjegjës për të siguruar lexim të saktë dhe të rregullt dhe do të sigurojë që entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve do të bëjë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin përkatës të Matjes”**. Në rastin konkret është konstatuar se KESCO nuk ka përmbushur kushtin ligjor që konsumatorit ti sigurojë një lexim të saktë dhe të rregullt në përputhje me këtë dispozitë ligjore.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO-së se konsumatori nuk është ankuar asnjëherë edhe në rastet kur është faturuar me një tarifë dhe i ka paguar faturat e energjisë elektrike, Bordi i ZRRE-së, konstaton se një pretendim i tillë nga ana e furnizuesit me energji elektrike është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi që konsumatori duhet të ngarkohet që të paguaj vetëm për atë që shpenzon dhe për rastet e gabimeve eventuale KESCO është e obliguar të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 23 paragrafi 3 të Rregullës për kushtet e përgjithshme në sektorin e energjisë ku theksohet: **“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”**.

Mbështetur edhe në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: **“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”**. Andaj mbi këtë bazë KESCO duhet të ngarkoi konsumatorin vetëm për energjinë e shfrytëzuar e jo të ngarkoi me shpenzime si rezultat i leximeve jo të rregullta.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se KESCO në ankesën e saj nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, andaj në mungesë të provave dhe fakteve konkrete Bordi ka konstatuar se ankesa e KESCO-



së nuk është e bazuar në prova dhe fakte konkrete, por që ka konstatuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla në fuqi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Krenar Bujupi, anëtar

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit Sh. V., dhe
- Arkivit të ZRRE-së